



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Shkurt 2022

Nr: 98

**VENDIM**

**PËR**

**LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR. 54 DHE KZAZ NR. 55, QARKU**

**FIER**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, janë kërkuar zëvendësime si më poshtë:

Lëvizja Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 1151 prot., datë 23.2.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ nr. 54 dhe KZAZ nr. 55, qarku Fier.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 29, pika 1, shkronja “c”, 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## VENDOSI:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ nr. 54, z. Blerim Sina dhe KZAZ nr. 55, z. Krenar Turku, qarku Fier.
2. Të emërojë anëtarët e KZAZ nr. 54, z. Indrit Qerimi dhe KZAZ nr. 55, z. Lazër Dakaj, qarku Fier.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

